



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp
(07 Qershor 2007)

**Mbi seancën dëgjimore me shoqërinë Albanian Mobile Communications për raportin
“Mbi hetimin e thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme”**

Në përfundim të raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme” dhe në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sot në ambjentet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë Albanian Mobile Communication-AMC, palë nën hetim.

Përfaqësuesit e shoqërisë AMC paraqiten argumentat e tyre në lidhje me raportin e përgatitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Pikat kryesore të diskutimeve u përqëndruan në përcaktimet e tregut përkatës, pozitën dominuese të shoqërisë në treg dhe abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese.

Përfaqësuesit e AMC-së paraqiten argumentat e tyre në lidhje me këto çështje dhe pretendimet kundrejt konkluzioneve të raportit përfundimtar se kjo kompani nuk ka pozitë dominuese dhe se nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg.

Në ditët e ardhshme në Autoritetin e Konkurrencës do të zhvillohet një tjetër seancë dëgjimore ku përfaqësuesit e shoqërisë Vodafone Albania do të paraqesin pretendimet e tyre pas vënies në dispozicion të raportit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës.

Me përfundimin e seancave dëgjimore dhe vënien në dispozicion të të gjithë informacionit të nevojshëm, Komisioni i Konkurrencës do të marrë një vendim përfundimtar mbi raportin “Për hetimin e thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme”.